


# TaxNews

*SPECIAL*

Dhjetor 2018  
December 2018



Në Fletoren Zyrtare nr. 183, datë 21.12.2018 është publikuar Ligji nr. 94/2018, date 03.12.2018, pjesë të Paketës Fiskale 2019 (pjesën e parë të Paketës Fiskale 2019 e kemi përmbledhur në Special Tax News të muajit korrik 2018). Ky Ligj hyn në fuqi më 01.01.2019.

### Ligji "Për tatimin mbi të ardhurat"

Ndryshimet në këtë ligj kanë si qëllim kryesor zgjerimin e bazës së të ardhurave të tatueshme në Shqipëri dhe lehtësimin e barrës fiskale për kategori të veçanta.

#### Të ardhurat nga shërbimet me burim në Shqipëri

Të ardhurat nga shërbimet e kryera nga personat jo rezidentë do të konsiderohen me burim në Shqipëri, dhe pra të tatueshme në Shqipëri, nëse ato kryhen për një person rezident, pavarësisht vendit se ku kryhen fizikisht e pavarësisht vendit nga i cili paguhen. Më parë, konsideroheshin me burim në Shqipëri, dhe pra të tatueshme në Shqipëri, vetëm të ardhurat e realizuara nga shërbimet e kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë nga personat jo rezidentë.

#### Të ardhurat nga pasuri të paluajtshme, minerale, hidrokarbure etj. me burim në Shqipëri

Krahas të ardhurave nga pronësia (dhe nga të drejta të tjera që rrjedhin nga pronësia) mbi pasuri të paluajtshme që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të konsiderohen të ardhura me burim në Shqipëri, dhe pra të tatueshme në Shqipëri, edhe të ardhurat nga:

- a. të drejtat për shfrytëzimin e pasurive minerale,
- b. të drejtat për shfrytëzimin e pasurive hidrokarbure,

Law no. 94/2018, dated 03.12.2018 has been published in the Official Gazette no. 183, dated 21.12.2018, part of the Fiscal Package 2019 (the first part of the Fiscal Package 2019 has been summarized in our Special Tax News of July 2018). This Law enters into force as of 01.01.2019.

### Law "On income tax"

The main objective of the changes in this law is extending the base of income taxable in Albania and relieving the tax burden for certain categories.

#### Income from services sourced in Albania

Income from services rendered by non-residents shall be considered as sourced in Albania, i.e. as taxable in Albania, if they are provided to a resident person, regardless of the place where they are physically carried out and the place from where they are paid. Previously, only income from services rendered by non-residents within the territory of the Republic of Albania were considered as sourced in Albania i.e. as taxable in Albania.

#### Income from immovable properties, mineral, hydrocarbon and other resources, sourced in Albania

In addition to income from ownership (or other rights that derive from ownership) of immovable properties located in the territory of the Republic of Albania, the following sources of income will also be considered as Albanian sourced i.e. as taxable in Albania:

- a. rights for exploitation of mineral resources,
- b. rights for exploitation of hydrocarbon resources,

- c. të drejta të tjera për shfrytëzimin e burimeve natyrore tokësore dhe ujore, përfshirë detin në Republikën e Shqipërisë, si dhe
- d. informacioni që u përket këtyre të drejtave.

Të drejtat e mësipërme dhe informacioni i lidhur me to do të trajtohen për qëllime të tatimit në Shqipëri sikur të ishin 'pasuri e paluajtshme'. Si të tilla, përveç të ardhurave nga shfrytëzimi i tyre, edhe të ardhurat nga tjetërsimi i tyre (kalimi i pronësisë mbi to) do të konsiderohen gjithashtu me burim në Shqipëri, pra të tatueshme në Shqipëri.

### Të ardhurat nga aksionet e pjesëmarrjet me burim në Shqipëri

Do të konsiderohen me burim në Shqipëri, dhe pra të tatueshme në Shqipëri, të ardhurat e realizuara nga personat jo rezidentë nga kalimi i pronësisë mbi aksione ose interesa pjesëmarrjeje, kudo që ato ndodhen, nëse:

- a. përgjatë një viti para kalimit të pronësisë,
- b. më shumë se 50% e vlerës së atyre aksioneve a interesave,
- c. i atribuohet direkt ose indirekt pasurisë së paluajtshme, të drejtave ose informacionit të përmendura më lart.

### Tatimi mbi dividendët dhe fitimet e ortakëve

Norma e tatimit mbi dividendët që u shpërndahen aksionarëve e mbi fitimet që u shpërndahen ortakëve do të ulet nga 15% në 8%.

Për dividendët/fitimet që shpërndahen nga shoqëritë rezidente në Shqipëri, kjo normë e reduktuar do të zbatohet mbi fitimet e paspërndara të realizuara në vitet 2018 e më parë, përfshirë rezervat dhe fitimet e kapitalizuara, me kusht që:

- c. other rights for exploitation of natural terrestrial and marine resources, including the seas in the Republic of Albania, as well as
- d. information that pertains to these rights.

The rights above and the information related to them shall be treated for tax purposes as if they were 'immovable properties' in Albania. As such, in addition to the income from their exploitation, income from their alienation (transfer of ownership over them) shall also be considered as with Albanian source, i.e. as taxable in Albania.

### Income from shares and participations sourced in Albania

Income earned by non-residents from the transfer of ownership over shares or participation interests, wherever they are held, shall be considered as with Albanian source i.e. as taxable in Albania, if:

- a. throughout one year prior to the transfer of ownership,
- b. more than 50% of the value of such shares or interests,
- c. derives directly or indirectly from immovable properties, rights or information mentioned above.

### Tax on dividends and profit shares

The rate of tax on dividends distributed to shareholders and profits shared to owners shall be reduced from 15% to 8%.

For dividends/profits distributed by companies resident in Albania, this reduced rate shall be applicable on retained earnings of the year 2018 and previous years, including reserves and capitalized profits, provided that:

- a. tatimi mbi dividendin, që i përket fitimeve të pashpërndara të viteve 2017 e më parë, të paguhet brenda datës 30.09.2019, ndërsa
- b. tatimi mbi dividendin për fitimin e vitit 2018 të paguhet brenda datës 20.08.2019.

- a. tax on dividends deriving from retained earnings of 2017 and previous years is paid within 30.09.2019, whereas
- b. tax on dividends deriving from the profit of 2018 is paid within 20.08.2019.

### Tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi

Do të rritet fasha e sipërme e të ardhurave që taten me normën 13%, nga 130,000 Lekë/muaj në 150,000 Lekë/muaj. Kështu, tabela e re për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi është si më poshtë:

E ardhura e tatueshme nga punësimi (Lekë/muaj)	Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi
0-30,000	0%
30,001-150,000	+ 13% të shumës mbi 30,000 Lekë
150,001-më tepër	15,600 Lekë + 23% të shumës mbi 150,000 Lekë

### Personal income tax on employment income

The upper limit of employment income taxable at 13% shall increase from 130,000 ALL/month to 150,000 ALL/month. The new scheme of personal income tax on employment income is as in the following table:

Taxable employment income (ALL/month)	Personal income tax on employment income
0-30,000	0%
30,001-150,000	+ 13% of the amount over ALL 30,000
150,001-more	ALL 15,600 + 23% of the amount over ALL 150,000

### Deklarimi dhe pagesa e tatim fitimit nga persona jo rezidentë

Persona jo rezidentë që përfitojnë të ardhura me burim në Shqipëri, dhe pra të tatueshme në Shqipëri, të cilët nuk janë subjekt i ndonjë forme tjetër tatimi mbi të ardhurat në Shqipëri, do të jenë subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri lidhur me këto të ardhura. Ata do të kenë detyrimin të dorëzojnë një deklaratë të veçantë të të ardhurave të tatueshme brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe të paguajnë shumën e tatimit të deklaruar.

Rregullat mbi parapagimet e tatim fitimit si dhe mbi kreditimin e tatimit të huaj nuk do të jenë të zbatueshme në këtë rast.

### Declaration and payment of profit tax by non-resident persons

Non-resident persons that earn income sourced in Albania i.e. income taxable in Albania, which are not subject to income tax otherwise in Albania, shall be subject to profit tax in Albania in relation to such income. They shall have the obligation to submit a special declaration of taxable income within the 31st March of the following year and pay the amount of tax declared therein.

The provisions of profit tax prepayment instalments and of the credit of foreign tax shall not be applicable in this case.

Një udhëzim i Ministrisë së Financave pritet të sqarojë më tej cilët jo rezidentë janë më specifikisht subjekt të këtij detyrimi si dhe të përcaktojë formatin e kësaj deklarate, mënyrën e llogaritjes së tatimit dhe të pagesës së tij.

### **Ndryshimi i pronësisë dhe penaltitetet për mos njoftimin e tij në bazë të Ligjit "Për procedurat tatimore"**

Ndryshimet në fjalë janë të paqarta dhe kanë nevojë për sqarim të mëtejshëm nga Ministria e Financave.

#### **● Tatimi mbi 'fitimin e konsideruar' të personit juridik subjekt të ndryshimit të pronësisë**

Nëse, gjatë një periudhe tatimore, pronësia direkte ose indirekte e kapitalit apo të drejtave të votës të një personi juridik ndryshon me më shumë se 20%, ai person juridik do të trajtohet sikur:

- a. të ketë shitur një pjesë proporcionale të aktiveve të veta me vlerën e tregut të tyre, dhe
- b. të ketë riblerë të njëjtat aktive me të njëjtën vlerë tregu.

Në këtë mënyrë, personi juridik subjekt i ndryshimit të pronësisë do të njohë një 'fitim të tatueshëm nga shitja e konsideruar e aktiveve' dhe do të llogarisë tatim fitimi mbi të.

Ky rregull zbatohet në rast se personi juridik subjekt i ndryshimit të pronësisë ka realizuar në 3 vitet paraardhëse një mesatare qarkullimi prej të paktën 500 milionë Lekë.

#### **● Përjashtimi nga tatimi i fitimit kapital nga shitja e aksioneve**

Në rastet kur:

- a. fitimi kapital i realizuar nga aksionarët nga shitja direkte apo indirekte e kapitalit a të drejtave të votës të një personi juridik në Shqipëri konsiderohet si e ardhur me burim në Shqipëri, dhe

An instruction of the Minister of Finance is expected to further clarify which non-residents are subject to this obligation and to determine the form of this declaration, the method of calculation and payment of tax.

### **Change of ownership and penalties for not notifying it based on the Law "On tax procedures"**

These amendments are not clear and need further clarification and instruction by the Minister of Finance.

#### **● Tax on the 'deemed profit' of the legal entity subject of the change in ownership**

If, during a tax period, the direct or indirect ownership of the capital or voting rights of a legal entity changes by more than 20%, that legal entity shall be treated as if:

- a. having sold a proportionate portion of its assets at their market value, and
- b. having repurchased the same assets at that same market value.

In this way, the legal entity subject of the change of ownership shall recognize a 'taxable profit from the deemed sale of assets' and shall calculate profit tax on it.

The provision above applies if the legal entity subject of the change of ownership has realized in the previous 3 years an average turnover of at least 500 million ALL.

#### **● Exemption from capital gains tax from the sale of shares**

In the cases where:

- a. the capital gain realized by the shareholders from the direct or indirect sale of the capital or voting rights of a legal person in Albania is considered as an income sourced in Albania; and

- b. personi juridik subjekt i ndryshimit të pronësisë llogarit dhe paguan tatimin mbi 'fitimin e konsideruar nga shitja e aktiveve' sipas parashikimeve të mësipërme,

atëherë, fitimi kapital i aksionarëve nuk do të jetë objekt tatimi mbi fitimi në Shqipëri.

- **Detyrimi për njoftim i personit juridik subjekt të ndryshimit të pronësisë dhe dënimet për mos njoftim**

Personi juridik subjekt i ndryshimit të pronësisë direkte ose indirekte të kapitalit apo të drejtave të votës me më shumë se 20%, ka detyrimin të njoftojë autoritetet tatimore mbi detajet e ndryshimit brenda 45 ditësh nga data e ndryshimit.

Në rast mos njoftimi, personi juridik dënohet me një penaltet të barabartë me 15% të vlerës së tregut të pjesës proporcionale të aktiveve.

Personi juridik ka gjithashtu detyrimin për njoftim brenda 45 ditësh nga ndryshimi i pronësisë direkte ose indirekte të kapitalit apo të drejtave të votës të tij nëse:

- a. ky ndryshim është me më shumë se 10% por me më pak se 20%, dhe
- b. përgjatë një viti para ndryshimit të pronësisë, mbi 50% e vlerës së këtyre aksioneve/të drejtave të votës i atribuohet direkt ose indirekt pasurive, të drejtave dhe informacioneve të konsideruara si 'pasuri të paluajtshme' në Shqipëri.

Mos njoftimi në këtë rast dënohet me penaltet të barabartë me 5% të vlerës së tregut të pjesës proporcionale të aktiveve, përveçse kur provohet se personi juridik nuk ishte në dijeni të këtij ndryshimi pronësie.

- b. the legal entity subject of the change of ownership calculates and pays the tax on the 'profit from the deemed sale of assets' based on the provisions above,

then the capital gain of the shareholders shall not be subject to profit tax in Albania.

- **Obligation of notification by the legal entity subject of the change in ownership and penalties for not notifying**

The legal entity subject to the direct or indirect change in ownership of its capital or voting rights by more than 20%, has the obligation to notify the tax authorities on the details of the change within 45 days from the date of change.

In case of failure to notify, the legal entity shall be subject to a penalty of 15% of the market value of the proportional portion of its assets.

The legal entity has also the obligation to notify within 45 days following a direct or indirect change in ownership of its capital or voting rights if:

- a. this change is for more than 10% but less than 20%, and
- b. throughout the one year prior to the change, more than 50% of the value of its shares/voting rights was directly or indirectly attributable to properties, rights and information considered as 'immovable properties' in Albania.

Failure to notify in this case shall be subject to a penalty equal to 5% of the market value of the proportional portion of the assets, unless it is proved that the legal entity was not aware of such change of ownership.

## Deloitte Contacts

### **Olindo Shehu, CPA**

Partner | Tax & Legal Services  
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit  
Gjeologji Miniera  
Tirana | Albania  
Mob: +355 68 60 33 116  
E-mail: [oshehu@deloitteCE.com](mailto:oshehu@deloitteCE.com)

### **Disclaimer:**

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

\*\*\*

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 263,900 professionals are committed to becoming the standard of excellence.